



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P.nr.02/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtares, Florije Zatriqi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Bute Noci, në çështjen juridiko-penale kundër të pandehurit, K. D nga Peja, për shkak të veprës penale, *lëndim i lehtë trupor neni 188 par.3 nënpar. 3.1 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së*, duke vendosur lidhur me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1545/2015, të dt. 05.01.2016, mbajti shqyrtimin kryesor, me dt.06.10.2016, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Lumturije Hoxha, të pandehurit K. D, mbrojtësit të tij av. Mustafë Kastrati me autorizim në shkresa të lëndës, të dëmtuarës M. D, Mbrojtësit të viktimës D H, me datë 06.10.2016, ndërsa me datën 07.10.2016, në mungesë të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, morri dhe publikisht shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri K D, i lindur me, nga babai S dhe nëna S e gjinisë S, me vendbanim në rr. “A Gj” nr..., ka të kryer shkollën e, i pa ..., i, , i gjendjes, i identifikuar sipas letërnjoftimit me nr. personal, lëshuar nga MPB -Prishtinë, më parë i pa dënuar nga gjykata, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 18.7.2015, rreth orës 11:00 në shtëpinë e tij në rr.”Ahmet Gjokolli” nr.56, K.Pejë, me dashje i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore viktimës së ndjeshme, të dëmtuarës M D të cilën e ka bashkëshorte, në atë mënyrë që pas mosmarrëveshjeve të mëparshme që kanë pasur në vazhdimësi, ditën kritike i pandehuri fillimisht e maltreton e pastaj e godet me kokë në hundë dhe me grushta të njëjtën në pjesë tjera të trupit, duke shkaktuar dëmtime të përkohshme trupore,

- me çka ka kryer veprën penale, *lëndim i lehtë trupor neni 188 par.3 nënpar. 3.1 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata konform dispozitave të nenit 7, 8 par.1, 9, 10 par.1, 17 par. 1, 21 par. 1 dhe 2, 41, 42, par.1 nën par. 1.1, 43 par.1.2, 45, 73, 74, dhe neni 188 par.3 nënpar. 3.1 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, dhe nenit 245, 246, 248 par.1 dhe 4, 359, 360, 361, 365, 366, 450 dhe 463 të KPPRK-së, të pandehurin e :

GJYKON

Me dënim me burg në kohëzgjatje prej **shtatë (7) muajve**, të cilin dënim i pandehuri do ta vuan pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet të paguaj, shpenzimet e procedurës penale shumë prej **njëzetë (20) euro** dhe paushallin gjyqësor shumë prej **tridhjetë (30) euro**, dhe atë në afat prej **pesëmbëdhjetë (15) ditësh**, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E dëmtuara M D, për realizimin e kompensimit të dëmit udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzën PP/II.nr.1545/2015, të dt. 05.01.2016, kundër të pandehurit K D, për shkak të veprës penale, *lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së.*

Prokurori i shtetit, ka bërë përmirësimin e dispozitivit të aktakuzës ashtu që pas fjalisë “e pastaj e godet “ duhet të jetë “ me grushta në hundë dhe në pjesë tjera të trupit duke shkaktuar dëmtime të përkohshme trupore”.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor, në të cilin të pandehurin e ka njoftuar me të drejtat e tij nga neni 323 të KPPRK-së, si dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe duke vepruar në kuptim të nenit 325 të KPPRK-së, të pandehurit i ka dhënë mundësinë që të deklarohej për pranimin ose mospranimin e fajësisë. Me këtë rast, gjykata e ka udhëzuar të pandehurin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 248 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3, të KPPRK-së, kështu që i pandehuri ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale që akuzohet, ashtu që gjykata shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me procedurën e provave.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe pas dëgjimit të fjalës hyrëse, gjykata në procedurën e provave ka dëgjuar të dëmtuarën në cilësi të dëshmitares M. D, ka dëgjuar ekspertin e mjekësisë ligjore Dr. Flamur Blakaj, dhe janë lexuar këto prova materiale: raporti i oficerit hetues

Rasim Mujaj i dt. 19.07.2015, raporti i oficerit policor Rifat Berisha i dt.18.07.2015, deklarata e të dëmtuarës e dhënë në polici me dt.17.7.2015, dhe me dt. 18.7.2015, deklarata e të pandehurit e dhënë në polici më dt. 18.7.2015, raporti mjekësor me numër 12407 dt. 18.7.2015 të lëshuar nga Spitali Regjional në Pejë, 28 fotografitë të bashkangjitura shkresave të lëndës, akt ekspertimi mjeko ligjor dt. 28.12.2015, i kryer nga dr. Flamur Blakaj, si dhe shkresat tjera të lëndës dhe së fundi është dëgjuar mbrojtja e të pandehurit.

I pandehuri në mbrojtjen e tij ka deklaruar se: mbet në tërësi pranë deklaratës së tij të dhënë në polici me dt. 18.07.2015, duke shtuar se ditën kritike ishte festa e bajramit dhe pasi i njëjti është kthyer në shtëpi ka vërejtur se e M. këtu e dëmtuara, me këpucë mbathur kishte hy dhe i kishte baltosur tepihat, e dëmtuara ka mohuar ti ketë zhytur tepihat e dhomës duke filluar të bëprrtas duke thënë se “unë nuk i kam zhyt tepihat por dikush tjetër”, dhe në ato momente ajo i ka përplasur dyert e dhomës unë i kam thënë shko në dhomë dhe le këtë punë. Më tutje i pandehuri deklaroi se nuk e ka shty as nuk e ka grushtu, nuk ka pas lëndime, nuk ka njohuri se prej nga e ka marr këtë lëndim në hundë. Ditën kritike menjëherë pas 10 min, ka shku në punë, dhe pasi është kthyer në shtëpi, e ka vërejtur të dëmtuarën se nga hunda i rrjedhte gjak, e ka pyetur se çka ka. Më tutje deklaroi se nuk ka njohuri se nga kush i ka marr lëndimet e dëmtuara duke shtuar se me të dëmtuarën kemi qenë tek mjeku për problemet e saj me hundë sepse vazhdimisht ka probleme me gjakderdhje nga hunda dhe se ditën kritike, kur e ka shty të dëmtuarën prezent ka qenë edhe babai dhe nëna e këtu të pandehurit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor, i ka nxjerrë të gjitha provat e propozuara nga palët e që gjenden në shkresa të lëndës dhe më pas ka vazhduar me fjalën përfundimtare.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën e tij përfundimtare, Prokurori i shtetit mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të saj, duke theksua se, nga mbrojtja e të pandehurit dhe me provat materiale të administruara, në tërësi u vërtetua se i njëjti është kryes i kësaj vepre penale për faktin se i njëjti ditën kritike i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarës, një gjë e tillë u vërtetua edhe me deklaratën e ekspertit mjeko ligjor Dr. F. B., i cili në këtë shqyrtim gjyqësor qëndroj pranë mrendimit të tij të dhënë në ekspertizën mjeko ligjore. Kjo mbështetet edhe në deklaratën e të dëmtuarës M. D. e cila ka deklarua se ditën kritike kishte qenë e sulmuar nga i pandehuri dhe për shkak të lëndimeve që kishte qenë e sulmuar nga i pandehuri kishte lajmëruar rastin në polici duke shtuar se e njëjta nga i pandehuri edhe më parë ka pasur raste të dhunës por për hir të fëmijës i cili tani i ka mbushur 2 vjet dhe për hir të ruajtjes së martesës e njëjta ka hesht. Deklarata e të pandehurit i cili në këtë shqyrtim gjyqësor mohon ta ketë kryer këtë vepër penale nuk zë vend sepse i njëjti këtë e bënë vetëm për ti ikur përgjegjësisë penale. Poqëse i referohemi mbrojtjes së të pandehurit i cili në kundërshtimin e tij flet për dashjen, cek se aktakuza është e pa mbështetëshme dhe nuk vërtetohet “dashja”, e në anën tjetër mohon ta ketë kryer veprën penale, gjithashtu deklaroi se nuk është marr për bazë mendimi i ekspertit mjeko ligjor, kjo gjë u vërtetua gjatë këtij shqyrtimi, nga të lartcekurat kemi

ardhur në përfundim se i pandehuri me veprimet e tij ka konsumuar elementin e posaçëm të kësaj vepre penale e që është lëndimi trupor, ku në rastin konkret është thyerja e kockës nazale të hundës ashtu që i pandehuri me dhunën që ka ushtruar ndaj të njëjtës ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor për çka flet edhe fotodokumentacioni i cili gjendet në shkresa të lëndës ku shihen lëndimet që i janë shkaktuar të dëmtuarës, andaj gjykatës i propozoj që të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Mbrojtësi i viktimave gjykatës ja prezanton fjalën përfundimtare të përpiluar me shkrim, ku i njëjti gjatë shqyrtimit e elaboron këtë fjalë përfundimtare.

E dëmtuara në fjalën përfundimtare deklaron se: e përkrah fjalën përfundimtare të prokurores dhe të mbrojtësit të viktimave.

Mbrojtësi i të pandehurit në fjalën përfundimtare deklaron se: me administrimin e provave nuk është vërtetuar pretenca e aktakuzës kurse për faktet vendimtare siq janë lidhja kauzale në mes të veprimit të pasojës prokuroria e nderuar nuk ka parashtruar prova me çka ka dështuar që të veprojnë sipas nenit 20 të KPRK-së. Shkresat e bashkangjitura me aktakuzë dhe të administruara si prova të gjitha pa përjashtim bazohen vetëm në deklaratën kudërthënëse të të dëmtuarës-viktimës së supozuar të dhënë në polici me dt. 17.07.2015 e të cilën e ka ndryshuar me dt. 18.07.2015, nga përmbajtja e aktakuzës dhe gjatë shqyrtimit prokuroria përkundër faktit se ka pasur obligim ligjor që tua fal besimin e njëjtë deklaratave të viktimës së supozuar dhe këtu të akuzuarit veprohet në të kundërtën duke e injoruar në tërësi gjatë tërë procedurës deklaratën e të akuzuarit dhe mohimin e tij të vazhdueshëm se nuk e ka shkaktuar lëndimin e duke ia falur tërësisht besimin vetëm deklaratës së viktimës, qëndrim ky që është në kundërshtim me parimet dhe dispozitat e KPRK-së. Aktakuza nuk ka të bashkangjitura prova të cilat kalojnë besimin e arsyeshëm të caktuar me nenin 19 të KPRK-së, i cili kërkon që provat të jenë konkrete dhe të artikulueshme. Gjatë procedurës me asnjë provë nuk është argumentuar se i akuzuari ka shkaktuar lëndimin e viktimës të cilin ne nuk e kontestojmë se ka ndodhur, as natyrën e lëndimit nuk e kontestojmë por kontestuese ka mbet dhe deri më tani nuk është vërtetuar se i akuzuari është ai që e ka shkaktuar këtë lëndim. Meqenëse kushtetuta dhe KPPRK-ja ndalojnë dhe përjashtojnë mundësinë që i akuzuari të dënohet vetëm mbi bazën e një prove siç është deklarata e të dëmtuarës gjykatës i propozojmë që aktakuza të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Kjo edhe për një fakt tjetër është shumë e çuditëshme se si viktimë paraqitet se është vazhdimisht e rrezikuar nga sjelljet e këtu të akuzuarit kurse me këmbëngulje dhe me procedura për dhunë në familje insiston që mbetet të jetoj në të njëjtën shtëpi, në të njëjtin ambient, në të njëjtat rrethana dhe me të njëjtin person i cili kinse vazhdimisht e maltreton, kjo nuk ka logjikë dhe argumenton qëllimin e vetëm të viktimës që të sigurojë vetëm strehimin në shtëpi sepse në të kundërtën njeriu normal në rastet kur është permanent i rrezikuar nga personi në afërsi të të cilit jeton dhe në ambientin në të cilin jetojnë me siguri se do të largohet nga rreziku ose do të kërkonte nga organet kompetente që

këtu i akuzuari të arrestohet dhe izolohet si person me rrezikshmëri shoqërore. Sa i përket fjalës përfundimtare të mbrojtësit të viktimave, e njëjta përveç sofizmave nuk përmban asgjë konkrete, andaj gjykatës i propozojmë që të akuzuarin në mungesë të vërtetimit të lidhjes kauzale në mes të veprimit dhe pasojës ta liroj nga akuza.

I pandehuri në fjalën e tij përfundimtare deklaron se: e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka diçka tjetër për të shtuar.

Gjykata pas analizimit të proave dhe vlerësimit të tyre të gjithanshëm, secilës veç e veç e në lidhje reciproke me provat tjera konform nenit 361 par.1, 2 të KPPRK-së, dhe pas vlerësimit të tyre vërtetoi këtë gjendje faktike.

Se i pandehuri, me datë 18.7.2015 rreth orës 11:00, në shtëpinë e tij në rr. "Ahmet Gjokolli" nr.56, K.Pejë, me dashje i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore viktimës së ndjeshme, të dëmtuarës M. D. të cilën e ka bashkëshorte, në atë mënyrë që pas mosmarrëveshjeve të mëparshme që kanë pasur në vazhdimësi, ditën kritike i pandehuri fillimisht e maltreton e pastaj e godet me kokë në hundë si dhe me grushte e godet të njëjtën në pjesë tjera të trupit, duke i shkaktuar dëmtime të përkohshme trupore.

Kjo gjendje faktike është vërtetuar, nga mbrojtja e të pandehurit, nga raporti i oficerit R. M.j dt. 19.7.2015, raporti i oficerit policor R. B. dt. 18.7.2015, deklarata e të dëmtuarës e dhënë në polici me dt.17.7.2015, dhe me dt. 18.7.2015, deklarata e të pandehurit e dhënë në polici më dt. 18.7.2015, raporti mjekësor me numër 12407 dt. 18.7.2015 të lëshuar nga Spitali Regjional në Pejë, fotografit e bashkangjitura shkresave të lëndës, akt ekspertimi mjeko ligjor dt. 28.12.2015, i kryer nga dr. F. B., si dhe shkresat tjera të lëndës.

Sa i përket propozimit të mbrojtësit të të pandehurit, që në cilësi të dëshmitarëve të dëgjohen V. D, M. S. dhe S. D, gjykata e refuzoj një propozim të tillë pasi që lidhur me këtë çështje penale kemi të bëjmë me vepër penale lëndim i lehtë trupor, ndërsa aprovoj propozimin e tij që në seancë të dëgjohet eksperti Dr. F. B., për çka eksperti në fjalë e sqaroi e sqroj ekspertizën e cila gjendet në shkresa të lëndës për rrethanën e lëndimeve dhe trajtimin mjekësor.

Nga raporti mjekësor i Emërgjencës të Spitalit Regional në Pejë, sipas protokollit 12407 të dt. 18.07.2015, dhe nga fotodokumentacioni për të dëmtuarën M. D, ka vërtetuar lëndimet e shkaktuara te të dëmtuarës më afër të përshkruara në këto raporte.

Nga ekspertiza e ekspertit mjeko ligjor Dr. F. B. e dt. 28.12.2015, gjykata ka vërtetuar natyrën dhe kategorinë e lëndimeve trupore që ka pësuar e dëmtuara M. ditën kritike nga i pandehuri në fjalë, nga e cila ekspertiz, rezulton se në rastin konkret bëhet fjalë për thyerje të kockës së hundës, me gjakderdhje nga hunda, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbrretës (jo i mprehtë), që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore ashtu

që dëmtimet e përshkruara si më lartë, të dëmtuarës i kanë shkaktuar dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

Nga fotot që janë pjesë e shkresave të lëndës, shihet qartë se e dëmtuara ka pësuar lëndime të lehta trupore e të cilat janë të përshkruara në raportin e emergjencës dhe ekspertizën e mjekut ligjor. Ndërsa sa i përket 28 fotografi në kolor të deponuara nga e dëmtuara, gjykata të njëjtat i vlerësoi, nga të cilat shihen lëndimet që ka pësuar e dëmtuara nga i pandehuri, për një periudhë më të gjatë kohore.

Gjykata duke u bazuar në këto dëshmi –prova materiale, për të cilat nuk ka dilema për faktet të cilat janë vërtetuar, këtyre provave ju fali besimin e plotë e të cilat janë në lidhje logjike dhe reciproke me njëra tjetrën.

Nga deponimi i të dëmtuarës – në cilësi të dëshmitares M. D, të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka vërtetuar këto fakte, se ka dhunë sistematike, mëtutje duke cekur se, në fillim sikurse çdo martesë ka qenë mirë, mirëpo bashkëshorti këtu i pandehuri K. D, i nxitur nga anëtarët e familjes së vet e posaqërisht nga prindërit e tij ka ushtruar tortura psikike, fizike sistematike ndaj saj, qëllimi ka qenë që ta largojnë nga shtëpia ku vëreteton fakti se pas këtyre torturave që ka ardh deri te thyerja e ashtit të hundës, menjëherë kanë ushtruar paditë për shkurorëzim në mënyrë që bashkëshorti të del e të punoj jashtë vendit dhe kjo dhunë ka zgjatë afërsisht një vit e gjysëm. Më tutje shton se në prokurori dhe në gjykatë i ka dorëzuar 28 fotografi (në gjykatë në kolor), ndërsa rastet tjera nuk i ka parqitur nga se ka dasht ta ruaj martesën për hir fëmijës së tyre Y. D, tani i ka mbush 2 vjet dhe është rëndë i sëmurë nga anemia dhe bronhitis, gjendja e të cilit është e papranueshme. Për djalin – Y., derisa e ka paraqitur rastin në polici nuk është interesuar dhe duke thënë se nuk ka kurrfarë obligimi ndaj djalit. Mëtutje shton se si çdo nuse që pastron shtëpinë kamë qenë e vetme aty dhe ka dëgjuar vjehrrën duke i thënë bashkëshortit – këtu të pandehurit K, se “ka hy M mbath”, atë ditë kam qenë duke pastruar, ka qenë ditë feste, Bajram, dhe si pasojë e kësaj ka ardh K. dhe më ka grushtuar kur kam qenë në sallën të shtëpisë dhe prej frigës kam shkuar në një dhomë të katit të parë, ai (këtu i akuzuari) e ka ndjekur pas, ka pasur diçka në dorë dhe nga frika nuk e ka pa se çka ka pas në dorë, dhe se më së shumti e ka grushtuar në kokë dhe se vjehrra i ka shkuar pas tyre duke i thënë “bjeri kokës, mos i bjerë trupit se i len sheja “. Në shtëpi kanë qenë vjehrra dhe vjehrra – gjegjësisht prindërit e këtu të akuzuarit K, duke shtuar se vjehrra e ka përcjellur dhunën fizike që është bërë ndaj të dëmtuarës. Më tutje e dëmtuara – dëshmitarja ka deklaruar se i akuzuari ka pasur diçka në dorë por nga frika nuk e ka vërejtur dhe se ka provu të ik, por diçka ka pasur në dorë por nuk e din se çka, nga se nga frika nuk e ka vërejtur por dorën vazhdimisht e ka pas të grushtuar dhe se e ka godit me kokë. Mëtutje deklaroi se punon si mësuese dhe se raportet me kolegët i ka shumë të mira. Pas ngjarjes kritike, ka vështirësi në frymëmarrje nga se i është thyer ashti i hundës dhe ka dhimbje të vazhdueshme të kokës. Gjithashtu deklaroi se ka pas dhunë edhe gjatë shtatzënisë dhe se kunata disa herë ka tentuar ta shtyj nga shkallët, pas ballafaqimit me

deklaratën e dhënë në polici e njëjta deklararon se mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë në polici.

Dëshmisë së të dëmtuarës - dëshmitares, gjykata ia fali besimin e plotë e cila në mënyrë shumë të qartë i ka spjeguar të gjitha veprimet e të pandehurit, përkatësisht e ka elaboruar ngjarjen kritike duke dhënë detalet më të plota të ngjarjes kritike dhe është plotësisht në lidhmëri reciproke dhe logjike me raportin mjekësor të Emërgjencës së Spitalit Regional në Pejë, sipas protokollit 12407 të dt. 18.07.2015, me ekspertizën e ekspertit mjeko ligjor të dhënë nga Dr. F. B., të dt.28.12.2015, fotot të bashkangjitura në shkresa të lëndës, të gjitha këto në raport me të dëmtuarën, me fotot mbi lëndimet e pësuar tek e dëmtuara, e të cilave prova gjykata iu fali besimin e plotë. Fakti se gjykata të dëmtuarës – dëshmitares ia fali besimin e plotë është se e njëjta në të gjitha fazat e procedurës ka deklaruar të njëjtën gjë pa ndryshime dhe se deklaratat e të dëmtuarës përputhen me provat nga shkresat e lëndës.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale, me propozimin e mbrojtësit të të pandehurit, ka ftuar edhe ekspertin e mjekësisë ligjore Dr. F. B., njëherit përpilues i ekspertizës së cekur më lartë, për të dhënë skjarimet e ekspertizës në prezencën e palëve prezentë, me çrast i njëjti ka deklaruar se: mjeti i fortë mbrretës do të thotë: mjet i topitur sepse fjala topitur nuk është në gjuhën shqipe, çdo mjet që nuk ka maje ose teh quhet mbrretës (jo i mprehtë) për sqarim bëjnë pjesë gjuri, grushti, bryli, koka, huri, etj. Më tutje cek se mendimin e ka dhënë në bazë të raporteve mjekësore, në rastin konkret fjala është për lëndim të lehtë trupor. Kur ka fraktur ose thyrje nuk nënkupton gjithmonë dëmtim të rëndë trupor sepse ka thyerje të shumta të kockave trupore të cilat cilësohen si lëndime të lehta trupore si psh. thyerja e kockës së hundës, thyerja e kockave të kokës pa e prekur bazën e kafkës, thyerja e një brinji, thyerja e një dhëmbi, thyerja e fibullës të njërit asht të kërcërit, thyerja e falangave të skajshme të gishtave, të gjitha këto hyjn në lëndime të lehta trupore, ka edhe tjera. Më tutje eksperti sqaron se njeriu mund ta damtoj veten e tij në mënyra të ndryshme edhe duke e godit me grusht vetveten, mund të lëndohet por nuk ka mundësi që vetes me grusht t'ia thyen kockën e hundës, dhe nuk është e mundur që me futjen e gishtave në hund njeriu të lëndohet si në rastin konkret.

Dëshmisë së ekspertit Dr.F. B., gjykata ia fali besimin e plotë, i cili në mënyrë shumë të qartë dhe profesionale e ka sqaruar ekspertizën e dt. 28.12.2015, dhe atë në prezencën e palëve gjatë seancës gjyqësore.

Gjykata duke vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit K. D., të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, konstaton se mbrojtja e tij është në kundërshtim me përmbajtjen e saj e po ashtu edhe me prova tjera materiale ndër të cilat edhe deklaratën e tij të dhënë në polici me dt. 18.07.2015, ku në mwes tjerash deklararon : “e shtyna me dorë pakëz në krahnor apo në qaf nuk jamë i sigurt, por pa e godit”, më tutje ka deklaruar se “ nuk e kam goditur në hund dhe nuk ka pasur gjakderdhje dhe vet i ka shti gishtat në hund me qëllim me i dal gjak”. Ndërsa në shqyrtim gjyqësor ka deklarua se “unë nuk e kam shty as nuk e kam grushtu”. Po

ashtu kundërshtohet edhe me dëshminë e të dëmtuarës, raportin e emërgjencës si dhe ekspertizën mjekoligjore, fotodokumentacionin dhe shkresat tjera të lëndës, për çka gjykata si të tillë e konsideron jo reale dhe nga këto arsye nuk mund ti falet besimi për vërtetimin e gjendjes faktike.

Nga këto arsye gjykata ka gjetur se, mbrojtja e të pandehurit është e orientuar në shmangie të përgjegjësisë penale të të pandehurit, nga se nuk ka mbështetje në provat e administruara.

Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike si është përshkruar në këtë aktgjykim, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale *lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së*.

Sa i përket fajësisë, i pandehuri ka vepru me dashje, duke qenë i vetëdijshëm për rëndësinë e veprimeve të veta dhe duke e dëshiruar shkaktimin e pasojave të cilat edhe i realizoi, andaj gjykata të njëjtin e gjeti fajtor dhe penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale në fjalë.

Në rastin konkret gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë që do të ishte me ndikim për zvoglimin e përgjegjësisë penale të të pandehurit, prandaj të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Gjykata i vlerësoi edhe vendimet e Mbrojtësit të Viktimave të cilat ia prezantoi gjykatës në fazën e përfundimtare të këtij gjykimi, C.nr.633/15 të dt. 30.07.2016 dhe C.nr.926/15 të dt.30.10.2016, por të njëjtat janë çështje të vendosura në departamentin civil si pasojë e rastit konkret që për çështjen penale nuk janë relevante.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, për të pandehurin, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata ka vlerësuar faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale, ngase për gjykatë nuk ka të dhëna se i njëjti ka ra në konflikt me ligjin dhe se ndaj tij nuk është në zhvillim ndonjë procedurë penale. Si rrethana rënduese për të pandehurin gjykata pati parasysh prezencën e dhunës në rastin e kryerjes së veprës penale. Gjykata si rrethana rënduese pati parasysh edhe mënyrën agresive të sjelljes dhe veprimet e të pandehurit të cilat kanë sjellur si rezultat pasojën e veprës penale, si dhe dhunën e vazhdueshme dhe raportet e acaruar në vazhdimësi ndaj të dëmtuarës, qëndrimi jopendues lidhur me veprimet e veta, shkalla e lartë e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer dhe shkalla e përgjegjësisë penale të të pandehurit.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, gjykata në kuptim të nenit 73 të KPRK -së, meqë është bindur se vendimi mbi dënimin, do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj

edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPRK-së, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale për të pandehurin shumë prej njëzetë (20) euro dhe paushallin gjyqësor shumë prej tridhjetë (30) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar gjatë kësaj procedure penale.

Vendimi që palën e dëmtuar ta udhëzoj në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike u morr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së, është vendosur si nën pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË –DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.02/16 të datë 07.10.2016

Sekretarja juridike

Gj y q t a r j a

Bute Noci

Floriqe Zatriqi

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit. Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.